



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 99, datë 24.04.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164/8, 166/2, 189/1/a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Erion Çela**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
2. Z. Erion Çela do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përkohësisht nga data 27.04.2020 - 26.07.2020.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Erion Çela do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
4. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Z. Erion Çela dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

